



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.127, datë 02.06.2022

PËR
“SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR DREJTUES TË PROKURORIVE TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM NËPËRMJET PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 52, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 9 (nëntë) vendeve vakante për Drejtues prokurorie, përmes procedurës së ngritjes në detyrë, në Prokuroritë e mëposhtme:
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Dibër;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastrë;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Kukës;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnjë;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Përmet;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Pogradec;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë;
2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit, do të njoftohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 02.06.2022.

KRYETARI

Alfred Balla

